



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-31757/17
Kaçanik, 20.09.2017

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX (Nëntë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e V-të), mbajtur më datë 20 Shtator 2017. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarët, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye anëtari, Tahir Çaka.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës –Remzi Elezi, drejtorë të drejtorive komunale (Bahri Selimi, Enver Kamishi, Diana Reka, Zylfi Koxha dhe Ramadush Osmani).

Në mbledhje morën pjesë edhe zyrtarët: Fatlume Guri- zyrtare për informim dhe Bejtulla Dalloshi-zyrtar i IT.

Mbledhjen e kryesoj, Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfëre Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Xhelal Gashi, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e IX (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2017- mbledhja e fundit e rregullt e legjislaturës së V (Pestë), data: 20 Shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Auditimit për Raportin Financiar të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016;
 - Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga të gjeturat e auditorit për PFV 2016;
3. Propozim Vendimi për transferin/rialokimin e mjeteve të projekteve kapitale brenda të njëjtit nën program buxhetor; dhe
4. Fjalë përshëndetëse dhe ndarja e Mirënjohjeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Pika e 1 dhe e 4 propozohen me hyrë në rend pune në mbledhje, pasi Procesverbalit është i gatshëm dhe i njëjti iu është dërguar anëtarëve të KK.

Për pikën 4, pasi është mbledhja përmbyllëse e KK për anëtarët e KK janë përgatitur Mirënjoyje të cilat do të shpërndahen në emër të komunës-përfaqësuesit të komunës, Besim Ilazi-Kryetar Komune. Gjithashtu do të mbahen fjalë përshëndetëse për ata të cilët donë me e përshëndetur aktivitetin e këtij kuvendi. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për këtë Rend pune. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, e :

APROVOJ

Rendin e Punës në Përbërje 4 pikave.

Kryesuesi i Kuvendit, Konstatoj me kalua në shqyrtimin e pikëve sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbalit i mbledhjes së kaluar të Kuvendit të Komunës aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ,

Procesverbalin e mbledhjes së VIII(Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 15 Shtator 2017 / Lënda: 01Nr. 60/01-30920/17.

2. Raporti i Auditimit për Raportin Financiar të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016;

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga të gjeturat e auditorit për PFV 2016;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, Raporti i Auditorit së bashku me Planin e veprimit janë shqyrtuar edhe në KPF.

Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga të gjeturat e auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të përfunduara me 31 dhjetor 2016, është hartuar nga Kryetari i Komunës, përmban të gjitha hapat dhe aktivitetet që duhet ndërmarrë si dhe personat përgjegjës të cilët janë obliguar që të përmirësojnë procesin organizativ. Për sqarime të nevojshme fjalën ia jap drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Theksoj së Raporti i Auditimit të Jashtëm është publikuar në Faqen të Zyrës Kombëtare të Auditorit. Në faqen 4 të Raportit, është përmbledhur opinionin e auditorit për Pasqyrat financiare. Opinionin e auditorit të përgjithshëm është opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, sipas opinionit pasqyrat Financiare Vjetore paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga të gjeturat e auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të përfunduara me 31 dhjetor 2016, përmban të gjitha hapat dhe aktivitetet që duhet t'i marrin zyrtarët përgjegjës, të cilët janë obliguar të përmirësojnë procesin organizativ. Janë gjithsej 24 të

gjetura të auditorit, disa prej tyre nuk janë me rrezik të lartë. Me rrezik janë diku 7-8 të gjetura.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Artan Shehu, Ky raport rikonfirmon atë se për 4 vite e kemi diskutuar si opozitë në kuvend, keq menaxhimin dhe keqpërdorim të parasë publike. Po ndalem të disa të gjetura nga 24 prej tyre;

-Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë 2; Nga 18 rekomandime nga viti paraprak, viti 2015, vetëm 5 janë zbatuar. Ndërsa për këtë vit kemi 24 rekomandime, për mua është shqetësuese; mos trajtimi i rekomandimeve të vitit 2015 dhe rritja e rekomandimeve në vitin 2016

-Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë 3; Sipas të gjeturave të auditorit janë: Komuna ende nuk ka hartuar listën e rreziqeve. Mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse të zhvillimit; dhe Mungesa e paqartësi brenda komunës.

Planet strategjike – Prioritet i lartë 4; Plan zhvillimi i përgjithshëm-apo siç kemi thënë në diskutime për 4 vite planet kopi paste na bien në situata të tilla, ku planeve strategjike u mungojnë llogaritjet e kostove, ndërsa planit kundër korrupsionit i mungon adresimi i çështjeve.

-Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë 5; Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Për komunën, Prokurimi mbetet ndër sfidat kryesore, pasi rregulloret nuk janë aplikuar si duhet, dhe kjo ka rezultuar në vlerë të dobët për para. Numri i madh i Aneks-kontratave përshkruan më së miri dobësitë në planifikimin e prokurimit, mosrespektimi i procedurave të prokurimit, pagesa pa dëshmi të mjaftueshme etj.

Si ekzekutiv, me thoni për hapat e marra për 4 vite për këto papërgjegjësi të Zyrës së Prokurimit, pasi në si opozitë vazhdimisht kemi pasur vërejte në punën e këtij sektori.

NJAB dhe Komiteti i auditimit – Prioriteti i lartë 6; Mungesa e kapaciteteve njerëzore në NJAB ka rezultuar në mos përmbushje të aktiviteteve të planifikuara të auditimit. ky problem përsëritet që 4 vite.

-Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë 7; -Vonesa për leje ndërtimi – Prioritet i lartë 9; Sikur kjo e gjetur të jetë për shkak të problemeve me pronat në qytet(pronat shoqërore), do ishte në rregull, mirëpo nga të gjeturat e auditorit nuk po del të jetë ashtu që është shumë shqetësuese, pasi do stimulojmë fillimin e ndërtimeve pa marre lejen, mos pagesë të taksave të ndërtimit etj. pra do kemi dëme shumë të mëdha.

-Mos arkëtimi i qirasë nga pronat publike – Prioritet i lartë 10; Vazhdimi i kontratave të qirasë, me qiramarrësit që nuk kanë kryer obligimet e qirasë. Pyetja ime është: nëse ndonjëri nga ju ka ndonjë lokal të dhënë me qera, a e vazhdon kontratën e qerasë me qiramarrësin që nuk paguan qiranë, besoj se jo, e atëherë përse e vazhdoni qiranë për objektet publike, vetëm se nuk ju prek gjepin tuaj. Kjo na bënë të dyshojmë edhe me shumë që të lind ndonjë keqpërdorim, këtë qasje duhet ndryshuar, nëse e duam Kaçanikun, më të zhvilluar.

-Mangësi në zbatimin e kontratave dhe kryerjen e pagesave – Prioritet i Lartë 13; Komuna kishte lidhur një kontratë me datën 02.02.2016 në shumë prej 53,810€ për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Më 17.03.2016 komuna kishte paguar OE në shumë 13,130 për një faturë të datës 26.02.2016 në emër të situacionit të parë për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore. Ne nuk kemi gjetur se organi mbikëqyrës ka konfirmuar me shkrim rregullsinë e situacionit të parë. Sipas analizës kemi vërejtur se komuna brenda 6 muajve ka realizuar këtë projekt, edhe pse kishte lidhur kontratë një vjeçare. Kjo është si rezultat i mos planifikimit të duhur të shpenzimeve, sepse komuna ka nevojë për tërë vitin të kryej

mirëmbajtjen verore dhe dimërore. Kjo i ka kushtuar kosto shtesë komunës duke lidhur edhe një kontratë me një operator tjetër.

-Lidhja e kontratës për punë shtesë – Prioritet i lartë 16; Me testimin e nëntë (9) mostrave nga investimet kapitale në shumë 539,923€, kemi gjetur se në pesë (5) raste ishin lidhur aneks kontrata për punë shtesë në shumë 10,935€, krejt kjo, si rezultat i mos planifikimit të duhur dhe përgatitjes së paramasave dhe parallogaritë.

Për mendimin tim, kjo bëhet që të eliminohet konkurrenca dhe tenderët t'i marrin kompanitë e preferuara nga Ekzekutivi, pasi janë në dijeni se do kenë edhe anekse shtesë, dhe në kontrata bazë aplikojnë thuaj se nën çmim të tregut.

-Sigurimi i tenderit për afat më të shkurtër sesa afati i kontratës – Prioritet i lartë 17; Besoj që kjo e gjetur ka ndodhur për shkak të neglizhencës së procedurave nga Zyra e Prokurimit.

-Sigurimi i ekzekutimit – Prioritet i Lartë 18; Me 18.03.2016 ishe lidhur kontratë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve në shumën vjetore prej 11,750€. Sipas kriterëve të dosjes së tenderit fituesi do duhej të paguaj 10% nga vlera e kontratës në emër të sigurimit të ekzekutimit. Nëse keni harruar, në kontratën e përshkruar me lartë, me intereson të dijë, se në tenderin e njëjtë por në fund të viti 2016 ku shuma e tenderit është 20,000 euro, a është kërkuar sigurimi i ekzekutimit, pasi përfituesi i tenderit është i njëjti operator ekonomik.

-Bashkëfinancimet dhe pagesat tjera – Prioritet i lartë 20; 25,000€ e paguar në llogari të donatorit në bazë të një Aneksi për ndërtimin e kulmit të shkollës në fshatin Stagovë, deri sa nuk kemi gjetur të bashkëngjitur para-masës dhe para-llogarinë e projektit, kjo krijon hapësira për dyshime në keqpërdorime.

-Rritja e vazhdueshme e borxheve të pa mbledhura - Prioritet i lartë 23; Ne nuk kemi vërejtur se komuna ka ndonjë strategji konkrete për inkasimin/zvogëlimin e të arkëtueshmeve. Nëse iu kujtohet, gati në çdo diskutim rreth buxhetit kam kërkuar trajtimin e borxheve përmes procedurave përmbarimore për rastet që kanë mundësi pagesë dhe nuk paguajnë, duke përjashtuar rastet sociale.

-Menaxhim i dobët i detyrimeve - Prioritet i lartë 24; Sipas një analize, del se komuna në vitin 2016, ka paguar fatura të vitit 2015 në shumë prej 126,590€, deri sa faturat e papaguara të prezantuara në fund të vitit 2015 ishin 69,400€. Sipas kësaj analize del se komuna nuk ka prezantuar drejt obligimet e saj duke shkaktuar nënvlerësimin e tyre prej 57,190€.

Kjo e gjetur e fundit e auditorit, të jep shume me kuptua si menaxhohet në përgjithësi komuna, për shkak se të tregojnë se ju nuk po e dini me ke keni kontrata, nuk i përcjellin kontratat dhe kompanitë mund t'iu faturojnë kur të duan dhe si të duan.

Për fund kam një lutje për të gjithë, që nëse duam një Kaçanik me të zhvilluar, duhet ta trajtojmë parandë publike siç e trajtonte i madhi, Shekspiri Paraja është një ushtar i mirë, dhe kështu do vazhdojë të jetë, duhet ta bësh parandë të punojë për vendin tënd.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj të fokusohemi të Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve sipas Raportit të Auditorit.

z. Shukri Luta, Ato të cilat i tha z. Artani, nuk do t'i përsërisë, sepse i tha në detaje. Sa herë që është debatuar për të gjeturat sipas Raportit të Auditorit, na është thënë nga ekzekutivi së auditorët nuk kanë qenë profesional. Sa i përket të gjeturave, nga Raporti kuptojmë se gjendja nuk është e mirë, sidomos tek të gjeturat rreth buxhetit të komunës. Shpresoj se nga sot e një vit këto të gjetura si në Raportin e auditorit të eliminohen.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka kështu kjo çështje u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 10 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga të gjeturat e auditorit për PFV 2016.

3. Propozim Vendimi për transferin/rialokimin e mjeteve të projekteve kapitale brenda të njëjtit nën program buxhetor;

Kryesuesi i Kuvendit, Ky propozim Vendim ka kaluar procedurën e KPF dhe i njëjti është aprovuar njëzëri nga ajo trupë punuese. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Meqë për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati. Abstenuan 4 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferin/rialokimin e mjeteve të projekteve kapitale brenda të njëjtit nën program buxhetor.

4. Fjalë përshëndetëse dhe ndarja e Mirënjohjeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo është mbledhja e fundit e Rregullt e Kuvendit të Komunës e kësaj legjislaturë, ndërkaq Kuvendi i Komunës ka mandat deri me konstituimin e legjislaturës së re, kështu nëse ndodhë diçka deri me konstituimin e kuvendit të ri, kjo legjislaturë mund të thërret mbledhje të Kuvendit të Komunës. Nëse donë me marrë kush fjalë për me përshëndetë këtë legjislaturë, lë të urdhëroj:

z. Osman Krasniqi, Unë e kam udhëhequr Mbledhjen e Parë Konstituive të Kuvendit, ndërkaq edhe tani po e marrë fjalën për një fjalë përshëndetje. I falënderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës për një bashkëpunim në këtë mandat 4 vjeçar., e falënderoj Kryesuesin e Kuvendit zotëri Xhelal Gashi për korrektësinë e treguar për këto 4 vite në udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Vërtetë ka qenë një funksionim i mirë i KK. Nëse ndonjëherë kam lënduar dike me sugjerimet e mia, është mirë ato t'i lëmë anash, sepse çështjet politike janë momentale dhe jo afatgjate. Unë mandatin e kam fituar në bazë të punës afatgjate, u jam mirënjohës atyre të cilët me kanë votuar. Iu dëshiroj fitore atyre të cilët kanë kandiduar shëndet, suksese në punë dhe në jetë dhe bashkëpunim, ndërkaq ata që nuk kanë kandiduar, shëndet, suksese në punë dhe në jetë në rrugëtime të mëtutjeshme.

z. Selim Reka, I falënderoj të gjithë (legjislativin, ekzekutivin) për bashkëpunim e në veçanti e falënderoj Kryesuesin e Kuvendit zotëri Xhelal Gashi për korrektësinë e treguar për udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Për gjatë kësaj legjislature ne si opozitë jemi mundua me qenë konstruktiv në çështjet që kanë qenë në interes të qytetarëve të komunës, ndonjëherë edhe kemi pasur kundërthënie, por duke menduar vetëm për të mirën e vendit dhe për interesa të

qytetarëve të komunës. Atyre që janë kandiduar, iu urojmë të fitojnë ulëse në Kuvend, suksese, të tjerëve që nuk janë kandiduar gjithashtu shëndet dhe suksese në punë dhe në jetë dhe rrugëtime të mëtejme.

z. Artan Shehu, Pasi është mbledhja e fundit si anëtarë i kuvendit komunal, se pari e falënderoj kryesuesin e kuvendit zotëri Xhelal Gashi për korrektësinë e treguar për këto 4 vite në udhëheqjen e mbledhjeve komunale. Për këto vite si anëtar i kuvendit, jam mundur të jap kontributin tim maksimal në të gjitha mbledhjet e Kuvendit për të mirën e përgjithshme të Komunës. Ndonjëherë për të argumentuar diskutimet jam dashur të flas me emra të përveçëm, nëse ndokush është ndier i fyer nga këto diskutime, i kërkoj ndjese, pasi qëllimi i diskutimeve nuk ka qenë për të ofenduar ndonjë person, por për të trajtuar problemet me të cilat ballafaqohemi. Duke menduar se ky kuvend, me shumë ka qenë monolog i opozitës, pasi shumë pak ka pasur debat nga pozita, këtë formë të debatit nuk do ja dëshiroja kuvendit të ardhshëm. Për fund dua t'iu falënderoj të gjithëve duke ju uruar, shëndet, fat dhe suksese.

z. Kemal Mërseli, Mendoj se ky kuvend ka qenë konstruktiv për ngritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve të komunës. Ka pasur debate pozitë-opozitë, dihet se debatet e tilla janë të natyrshme. Besoj se ky kuvend ka funksionuar mirë, për këtë iu falënderoj të gjithëve. E falënderoj Kryesuesin e Kuvendit, Xhelal Gashi për korrektësinë e treguar për këto 4 vite në udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Ndërkaq atyre të cilët janë kandiduar me marrë edhe një mandat, iu uroj fitore, shëndet, ndërkaq edhe atyre të cilët nuk janë kandiduar, iu dëshiroj shëndet, suksese në rrugëtime të mëtejme dhe punë të mbarë në të gjitha sferat e jetës.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, I falënderoi delegatët e kuvendit për punën që e kanë bërë për ngritjen e mirëqenies sociale. E falënderoj Kryesuesin e Kuvendit, Xhelal Gashi për korrektësinë e treguar për këto 4 vite në udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Kritikën e juaja, vërejtjet dhe sugjerimet, të cilat kanë pasur gjithmonë një qëllim të përbashkët- të mirën qytetare, çdo herë i kam pranuar, disa edhe në heshtje. Apeloj që edhe në mandatin tjetër të jetë një kuvend i përgjegjshëm dhe me integritet, ndërsa kujtoj së Kaçaniku edhe në këto zgjedhje duhet ta ruaj traditën e krijuar, për organizimin e zgjedhjeve të qeta dhe demokratike. Ata të cilët janë kandiduar me marrë edhe një mandat, iu uroj fitore, atyre të cilët nuk janë kandiduar, iu dëshiroj shëndet, suksese dhe punë të mbarë në rrugëtime të mëtejme, ndërkaq kërkoj falje nëse e kam lënduar dike për gjatë këtij mandati.

Kryesuesi i Kuvendit- Xhelal Gashi, Për kontributin e anëtarëve të KK në emër të Komunës është përgatitur nga një Mirënjohje për 27 anëtarët e KK dhe 1 Mirënjohje Post Mortum për anëtarin e ndjerë Ilaz Ceka, i cili nuk arriti të përfundojë mandatin e kësaj legjislature.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës i nderuari Kryetar, Nënkryetarë, Drejtorë të Drejtorive Komunale dhe të pranishmit tjerë, është bërë një kohë e gjatë e shërbimit tim në këtë pozicion. Çdo fillim e ka edhe fundin. Iu falënderoj të gjithëve për angazhimet e juaja për gjatë mandatit 4 vjeçar dhe për bashkëpunimin që kemi pasur me mua dhe Kuvendin e Komunës në përgjithësi. Udhëheqja e Kuvendit të Komunës është një detyrë mjaftë e rëndë. Mbledhjet e Kuvendit janë menaxhuar mirë, ka pasur gjithmonë atmosferë pune, ndërsa

Kuvendi i Kaçanikut është shembull i mirë edhe për komunat e tjera. Nëse kjo udhëheqje e imja vlerësohet se ka qenë e mirë, meritoret jeni ju, për këtë iu falënderoi të gjithëve.

Falënderoj edhe ekzekutivin e komunës të cilët na janë përgjigjur në çështjet të cilat i kemi ngritur, sepse nganjëherë kemi kërkuar informata të shpejta, por në bashkëpunim ia kemi dalë.

Ndërkaq në vazhdim, në shenjë falënderimi për punën dhe angazhimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Kryetari i Komunës së Kaçanikut do të ndan për secilin anëtarë të KK nga një Mirënjohje. Unë do të i thërras me emër secilin anëtarë të KK ashtu siç i kanë emrat e shënuar në mirënjohje të vijnë me marrë Mirënjohjen, ndërkaq me secilin anëtarë, unë së bashku me Kryetarin e Komunës do të bëjmë nga një foto.

Në shenjë kujtimi në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës të kësaj legjislaturë dhe Kryetarin e Komunës, të realizojnë një Foto të përbashkët.

Ndërkaq mos harroj të e përmendi së një falënderim i veçantë në emër të Kuvendit të Komunës shkon për zyrtaren e Kuvendit të Komunës, Makfîre Malsiu, e cila ka qenë sa herë në nivel të detyrës.

Ndërkaq në fund, Kryesuesi i Kuvendit anëtarët e Kuvendit të Komunës, Ekzekutivin e Komunës dhe Stafin Administrativ që kryejnë punë për Kuvendin e Komunës, i ftoj për një drekë pune në restorant "Beni" në Kaçanik- magjistratja për Ferizaj, në shenjë respekti për aktivitetin e Kuvendit të Komunës për një punë të palodhshme dhe konstruktive të Legjislaturës së V të Kuvendit të Komunës të dalë nga Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntor 2013.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 12:05 e konstatoj mbledhjen të përfunduar.

Procesmbajtës
Makfîre Malsiu

Makfîre Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-31757/17
Kaçanik, 20.09.2017

DREJTORISË PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM,
-këtu-

Lënda: U dërgojmë Regjistrin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, nga mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 20 Shtator 2017.

Bashkangjitur me këtë shkresë u dërgojmë, Regjistrin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 20 Shtator 2017.

Nga përbërja e përgjithshme prej 27 anëtarëve sa ka Kuvendi i Komunës, në këtë mbledhje kanë marrë pjesë 26 anëtarë, mungoj me arsye 1 anëtar.

Për kompensim për pjesëmarrje në mbledhje janë gjithsej 25 anëtarë, sepse Kryesuesi i Kuvendit nuk kompensohet për pjesëmarrje në mbledhje.

Regjistrin u dërgojmë me qëllim që t'i ndërmerri veprimet e nevojshme për kompensim, në pajtim me Udhëzime të Qeverisë së Republikës së Kosovës që janë në fuqi dhe në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës për kompensim e stafit politik.

Shkresa për dorëzim të regjistrit, përmban numrin e Ftesës për mbledhje:
01Nr. 60/01-31757/17












Shtojcë: Regjistrin me 25 nënshkrime



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës, 03 Nëntorit 2013)

Evidenca për pjesëmarrjen e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e IX (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, mbajtur më datë, 20 Shtator 2017

1	2	3	5
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
01.	Bajram Baftiri	Anëtar	
02.	Ramadan Dema	"	
03.	Osman Krasniqi	"	
04.	Sabedin Vishi	"	
05.	Kemal Mërseli	"	
06.	Nexhat Loku	"	
07.	Arbesa Berisha	"	
08.	Pranverë Loku-Zharku	"	
09.	Arbnora Kuka	"	
10.	Fitore Luzha	"	
11.	Hajdar Loku	"	
12.	Kadri Krivenjeva	"	
13.	Lirije Qeli-Luta	"	
14.	Tahir Çaka	"	
15.	Sherife Troni	"	
16.	Selim Reka	"	
17.	Artan Shehu	"	
18.	Nazife Krasniqi	"	
19.	Lejla Koxha-Shehu	"	
20.	Basri Kodra	"	
21.	Raif Kasa	"	
22.	Vlora Dema	"	
23.	Avni Tafili	"	
24.	Lebibe Bela	"	
25.	Shukri Luta	"	
26.	Samira Burrniku	"	

Vërtetohet, Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 03 Nëntorit 2013);

**nga Mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt për vitin 2017, mbajtur me datë,
20 Shtator 2017.**

1. Xhelal Gashi,..... ,
2. Bajram Baftiri..... ,
3. Ramadan Dema..... ,
4. Osman Krasniqi,..... ,
5. Sabedin Vishi,..... ,
6. Kemal Mërseli,..... ,
7. Nexhat Loku,..... ,
8. Arbesa Berisha,..... ,
9. Pranverë Loku- Zharku..... ,
10. Arbnora Kuka,..... ,
11. Fitore Luzha..... ,
12. Tahir Çaka,..... ,
13. Hajdar Loku,..... ,
14. Kadri Krivenjeva,..... ,
15. Lirije Qeli- Luta..... ,
16. Sherife Troni,..... ,
17. Selim Reka,..... ,
18. Artan Shehu,..... ,
19. Nazife Krasniqi,..... ,
20. Lejla Koxha-Shehu..... ,
21. Basri Kodra,..... ,
22. Raif Kasa,..... ,
23. Vlorë Dema,..... ,
24. Avni Tafili,..... ,
25. Lebibe Bela,..... ,
26. Shukri Luta,..... dhe
27. Samira Burniku,..... .



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK		
I	Data	26.09.2017
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	Nr. 60/01-317	57/17

PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Xhelal Gashi

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së IX (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 20 Shtator 2017.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë : 20 Shtator 2017, dhe atë:

1. Vendimi për Transferimin/ Rialokimin e mjeteve të projekteve kapitale brenda të njëjtit nënprogram buxhetor / Lënda 01Nr. 400/01-31515/17;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga të gjeturat e auditorit për PVF 2016/ Lënda: 01Nr. 400/01-31513/17.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi